



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 14 Prill 2021

Nr: 17

VENDIM

PËR

**RREGULLAT PROCEDURALE PËR PROCESIN E VOTIMIT DHE NUMËRIMIT
ELEKTRONIK NËPËRMJET PAJISJES ELEKTRONIKE TË VOTIMIT DHE NUMËRIMIT
(PEVN) TË QENDRAVE TË VOTIMIT TË ZONËS SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR NR.40
NË QARKUN TIRANË, PËR ZGJEDHJET E KUVENDIT, TË DATËS 25 PRILL 2021**

Në mbështetje të neneve 20, pika 2, shkronja “c”, dhe 22, pikat 1 e 3, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I:

1. Çdo qendër votimi (QV) në Zonën e Administrimit Zgjedhor (ZAZ-në) nr. 40 të qarkut Tiranë të këtë dy pajisje elektronike të votimit dhe numërimit (PEVN) që mundësojnë votimin elektronik në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021.
2. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve udhëzon anëtarët e KZAZ-së dhe KQV-ve nën juridiksionin e saj për veprimtaritë operacionale që lidhen me marrjen në dorëzim dhe kthimin e bazës materiale zgjedhore.
3. KQV, për procedurat të cilat nuk janë të automatizuara, zbaton rregullat e përcaktuara në vendimin nr. 11, datë 25 mars 2021, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e ngritjes, organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në Qendrën e Votimit”, ndërsa për procedurat e identifikimit, votimit dhe numërimit elektronik vepron në përputhje me udhëzimet operacionale të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
4. KZAZ-ja i dorëzon KQV-së:

- a. Materialet zgjedhore të përcaktuara në nenin 18 të vendimit r. 11 datë 25.03.2021 “Për mënyrën e ngritjes, organizimit, funksionimit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në Qendrën e Votimit”.
 - b. PEVN-të me kutitë shoqëruese që mundësojnë votimin elektronik
5. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendos të vijojë procedurën e votimit me fletë votimi sipas vlerësimit të situatës nga ana e tij.
 6. Zgjedhësi, që për arsye fizike nuk është në gjendje të kryejë vetë procedurat e votimit, mund të kërkojë ndihmën e një familjari ose zgjedhësi tjetër, që është në listën e zgjedhësve të asaj zone të qendrës së votimit. Të dy zgjedhësit duhet të jenë të pranishëm në qendrën e votimit kur përdoret kjo procedurë. Një person mund të ndihmojë vetëm një zgjedhës që nuk mund të votojë vetë.
 7. Procesi i nxjerrjes së rezultateve për çdo QV dhe në rang ZAZ-je realizohet nga KZAZ-ja nr. 40 në ambientin e VNV-së përcaktuar nga KQZ.
 8. Pas mbylljes së votimit, KQV-të çojnë pranë VNV-së pajisjet PENV, së bashku me materiale të tjera zgjedhore.
 9. Pas dorëzimit nga të gjitha KQV-të pranë KZAZ-së të pajisjeve dhe materialeve përkatëse, KZAZ-ja mbyll ambientin ku do të kryhet numërimi. Rezultatet do të shpallen të nesërmen e ditës së votimit në ora 08:00. Gjatë natës, ambienti vëzhgohet me kamera të cilat sigurojnë regjistrimin dhe transmetimin e pamjeve gjatë gjithë kohës në serverin e KQZ-së. KQZ-ja u mundëson subjekteve zgjedhore me kërkesë të tyre të shikojnë nga pajisjet e veta pamjen e ambientit ku ruhen materialet zgjedhore.
 10. KZAZ-ja nr.40 në prani të vëzhguesve kryen procesin e numërimit të votave në Sistemin Elektronik të Menaxhimit të Votimit dhe Rezultateve (SEMVR) sipas procedurave teknike dhe operacionale të përcaktuara në dinamikë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
 11. SEMVR do të kryejë përlllogaritjen e rezultatit dhe do të shfaqë në monitor e do të printojë në letër tabelat e rezultateve për çdo QV si dhe Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve për ZAZ-në sipas modeleve të miratuara nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
 12. Tabelat e rezultateve, si për QV-në dhe për ZAZ-në, firmosen nga anëtarët e KZAZ-së. Tabela Përmbledhëse e Rezultateve miratohet me vendim nga KZAZ-ja.
 13. Në rastin kur procedura e votimit është zhvilluar në njërin pjesë të ditës elektronikisht dhe në një pjesë tjetër të ditës është zhvilluar manualisht, KZAZ aktivizon GNV-të të ndjekin

procedurat standarde për hapjen e kutive të votimit, numërimin, vlerësimin dhe nxjerrjen e rezultateve sipas udhëzimeve të KQZ-së vetëm pasi sistemi ka gjeneruar raportin me rezultatet e votimit për pjesën elektronike.

14. Administrata e KQZ-së në godinat ku janë të vendosura Qendrat e Votimit vendos pajisje simuluese me të dhëna ilustruese me qëllim edukimin dhe informimin e zgjedhësve për mënyrën e votimit elektronik, dhe harton pyetësor për të vlerësuar përshtypjet e zgjedhësve lidhur me përdorimin e teknologjisë në zgjedhje.
15. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, kujdeset për informimin e zgjedhësve dhe të administratës zgjedhore në lidhje me përdorimin e PEVN-së.
16. Në përfundim të procesit të votimit dhe numërimit elektronik, dhe pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve harton një raport analitik mbi gjetjet dhe efektshmërinë e përdorimit të teknologjisë në KZAZ nr. 40, Qarku Tiranë.
17. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
18. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës Administrative së Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO **Kryetar**

Arens ÇELA **Anëtar**

Dritan ÇAKA **Anëtar**

Helga VUKAJ **Anëtar**

Muharrem ÇAKAJ **Anëtar**

